



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 55 e 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kuvendi miraton në seancë plenare ngritjen e 11 komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë si më poshtë:

- Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.
(Çështjet e politikave ekonomike me përqasjen ndaj tregut të përbashkët europian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtoreve, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.)
- Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.
(Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin europian, organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor, administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)
- Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes.
(Çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e forcave të armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak, çështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)
- Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.
(Çështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikat e zhvillimit të sportit.)

- Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale.
(Çështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqenien sociale.)
- Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.
(Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)
- Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.
(Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)
- Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.
(Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore)
- Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.
(Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, politikat për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)
- Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme.
(Çështjet e integritetit europian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Europian, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Europian për Shqipërinë, monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian, politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)
- Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.
(Çështjet për përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin ligjvënës dhe në hartimin e politikave publike, çështje të bashkëpunimit ndër-institucional, çështje të mbikëqyrjes institucionale dhe kontrollin e zbatimit të ligjit, si dhe forcimin e dialogut ndër-institucional.)

Neni 2

Në nenin 20 pika 3 shfuqizohet.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI